

Shënimet Shpjeguese për Pasqyrat Financiare për periudhën 1 Janar 2019 deri 31 Dhjetor 2019

Informacion i përgjithshëm

Pasqyrat Financiare të subjektit për vitin 2019 janë përgatitur në zbatim të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit dhe ligjit Nr. 9228 Dt. 29.04.2004 për "Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe në paraqitje të drejte dhe në pajtueshmëri me SNRF-te.

Pasqyrat financiare të cilat janë në pajtueshmëri me SNRF-te kanë bërë një deklaram të qarte dhe pa rezervë.

Pajtueshmëria me SNRF-te për të dhënë një paraqitje të drejte kërkon që njësia ekonomike :

a) të zgjedhe dhe të zbatojë politika kontabël në përputhje me SNK 8"Politikat kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet" e cila paraqet një udhëzues të hierarkisë së autoritetit që drejtimi duhet të marrë parasysh në mungesë të SNRF-je që zbatohet në mënyrë specifike tek një zë.

b) të paraqesë informacionin, përfshirë politikat kontabël, në mënyrë që të siguroj informacion të rendesishëm, të besueshëm, të krahasueshëm dhe të kuptueshëm.

c) të sigurojë dhënie informacioni shpjegues shtese atëherë kur pajtueshmëria me kërkesa të caktuara të SNRF është e pajtueshme që ti mundësoji përdoruesit të kuptojë ndikimin e transaksioneve të caktuara, ngjarjeve dhe kushteve të tjera, në pozicionin financiar dhe performancën financiare të njësisë ekonomike.

Politikat të papërshtatshme kontabël nuk korrigjohen as në dhënie informacionesh shpjeguese të politikave kontabël të përdorura dhe as nëpërmjet shënimeve shpjeguese.

Parimet e përdorura për hartimin e Pasqyrave Financiare sipas SNRF-se janë :

a) Vijimësia, drejtimi do të bëjë një vlerësim të aftësisë së njësisë ekonomike për vazhdimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

b) Kontabiliteti mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, njësia ekonomike do të përgatisë pasqyrat e saj financiare duke përdorur kontabilitetin mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, përveç pasqyrave lidhur me fluksin monetar.

c) Materialiteti dhe Bashkimi, e cila përdoret për çdo klasë materiale e zërave të ngjashëm do të paraqiten veçmas në pasqyrat financiare. Zëra që nuk janë të së njëjtës natyre ose funksion janë të paraqitura veçmas me përjashtim të rastit nëse janë material.

ç) KOMPENSIM, aktivet dhe detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimeve nuk ka kompensime, vetëm në rastet kur lejohen ose kërkohet nga një SNRF.

d) KUPTUESHMERIA e Pasqyrave Financiare është realizuar në masën e plote për të qenë të qarta dhe të kuptueshme për përdorues të jashtëm që kanë njohuri të përgjithshme të mjaftueshme në fushën e kontabilitetit.

e) Periudha e Raportimit, paraqitet një grup i plote i pasqyrave financiare (përfshirë informacionin krahasues) të paktën një herë në vit.

f) Informacioni Krahasues, të gjitha shumat e raportuara në pasqyrat financiare kanë paraqitur informacionin krahasues në lidhje me periudhë e shkuar për të gjitha shumat e raportuara në pasqyrat financiare të periudhës aktuale.

g) Qëndrueshmëria e paraqitjes, janë ruajtur paraqitja dhe klasifikimi i zërave në pasqyrat financiare nga njëra periudhë në tjetrën.

Politikat kontabël

Baza e matjes e përdorur në përgatitjen e pasqyrave financiare janë : për mallrat e materialet që bëhen hyrje në magazine bëhen me çmime blerje, dhe vlerësimi i inventarëve është zgjedhur metoda e "kostos mesatare".

Vlerësimi fillestar i një elementi të AAM që plotëson kriteret për njohje si aktiv në bilanc është vlerësuar me kosto .

Për AAM që financohen nga një hua , kostot e huamarrjes (dhe interesat) është metoda e kapitalizmit në koston e aktivit për periudhën e investimit .

Për vlerësimin e AAM është zgjedhur modeli i koston duke i paraqitur në bilanc me kosto minus amortizimin e akumuluar .

Për llogaritjen e amortizimit të AAM , njësia jone ekonomike ka përcaktuar si metode të amortizimit në zbatim të Ligjit 10228 datë 04/02/2010 , metoda e amortizimit në bazën e vlefës së mbetur ndërsa normat e amortizimit janë përdorur të njëjlojta me ato të sistemit fiskal në fuqi dhe konkretisht:

- Rrjeti ujësjellësve me 3%
- Ndërtesat dhe makineritë e pajisjet 5% mbi vlerën e mbetur
- Mjetet e transportit 20% të vlerës së mbetur
- Pajisjet informatike 25% të vlerës së mbetur

SHENIMET SPJEGUESE PËR AKTIVEVE DHE DETYRIMEVE

Shënimet që shpjegojnë zërat e ndryshëm të pasqyrave financiare të aktiveve dhe detyrimeve janë paraqitur me vlerën e mbetur kontabël siç janë paraqitur në fund të periudhës së raportuar .

I . Aktivet Afatshkurtra në vlerën 1.219.447.104 leke , e përbëre nga:

1. ***Aktivet monetare në vlerën 47.598.223 leke***, shoqëria ka operuar gjatë vitit 2019 me 11 banka , me llogari të ardhurave dhe shpenzimeve , me monedhën bazë , leke.

Mjete monetare të arkëtuara në llogaritë bankare për vitin 2019 janë 566.353.514 leke

Mjete monetare të dala në llogaritë bankare për vitin 2019 janë 656.743.900 leke

Mjete monetare të gjendje në llogaritë bankare nga viti 2018 janë 42.792.163 leke

- ***Te drejta të arketueshme***

Llogaritë e arketueshme janë paraqitur në kontabilitet me vlerën e tyre neto të realizuar gjendje me 31.12.2019 në vlerën 1.076.784.259 leke e përbëre nga:

- Nga aktiviteti i shfrytëzimit janë klientë nga shërbimi i furnizimit me ujë ,për vitin 2019 paraqiten :

<i>Fatura të pa likuiduara çelje</i>	<u>leke 1.015.593.294</u>
<i>Fatura të likuiduara</i>	<u>leke 374.225.956</u>
<i>Fatura të krijuara gjatë vitit</i>	<u>leke 397.910.704</u>
<i>Fatura të pa likuiduara</i>	<u>leke 1.039.278.042</u>

- Te drejta të tjera , në vlerën 37.506.217 leke e cila është e përbëre nga:

- *Debitor për paradhënie ,për 8.500 leke* , e cila është e përbëre nga debitorë për paradhënie blerje materiali .

- *Detyrime T.V.SH.*

<i>Tvsh e zbritshmi në çelje të vitit</i>	<u>leke 24.296.946</u>
<i>TVSh e zbritshmi në blerje gjatë vitit</i>	<u>leke 80.988.402</u>
<i>TVSh e paguar në shitje gjatë vitit</i>	<u>leke 81.905.761</u>
<i>TVSh e zbritshmi në mbyllje të vitit</i>	<u>leke 23.379.587</u>

- *Detyrime për ndalese KLSH në vlerën 13.750.984 leke,e ndare për punonjësit e shoqërisë në vlerën 1.643.391 leke dhe detyrim për tu arkëtuar nga subjekte tenderues në vlerën 12.104.593 leke , 346.607 leke arkëtuar gabim në llogarinë tone dhe 20.539 leke tatim fitimi i paguar për Orikumin .*

- **Inventari** Janë kryer inventarët fizik të materialeve në datë 31/12/2019.

Shoqëria ka përdorur metodën e “ çmimit te blerjes “ dhe ne fund te vitit gjendja e mallrave është vlerësuar me koston e magazinimit.

Inventari përbëhet:

- *Lende te para dhe materiale ndihmese për* leke 93.084.010
- *Inventar i imët për* leke 1.980.612
- **Shpenzime te shtyra** ne vlerën 206.558.666 leke pasqyron vlerën e papërfshire ne pasqyrën financiare te faljes se detyrimeve te klientëve sipas VKM Nr 10418 datën 21.04.2015 "Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese te Borxhit Tatimor dhe doganor", neni 30 dhe vendimit te Keshillit Mbikëqyrës Nr 8 date 24.11.2015.

A Aktivet Afatgjata, paraqiten me vlerën kontabël neto prej **6.046.570.551** leke e cila përbëhet nga :

1. **Aktive afatgjata materiale** për **5.984.986.190** leke.
2. **Aktive afatgjata jo materiale** për **61.584.361** leke

Aktivet afat gjate materiale janë te evidentuara ne kontabilitet me koston e blerjes te tyre . Ne pasqyrën e bilancit te datës 31/12/2019 aktivet afat gjate materiale janë paraqitur me vlerën kontabël neto .

Për këto mjete shoqëria ka llogaritur amortizim ,duke përdorur metodën lineare te përcaktuar ne ligjin Nr 8438 date 28/12/1998 “Për tatimin mbi te ardhurat” i ndryshuar.

000/leke

<i>Nr</i>	<i>Emërtimi</i>	<i>Vlera 1.01.2019</i>	<i>Shtesa</i>	<i>Am.mba</i>	<i>Am.vjet</i>	<i>Paksim e</i>	<i>Vl.neto 31.12.2019</i>
1	AAGJ materiale	7.197.820	679.211	1.687.617	201.069	3.359	5.984.986
	Gjendje 1.12.2019	7.197.820		1.687.617	201.069	3.359	5.984.986
	AAGJ jo Material	72.919		466	10.868		61.585
	TOTALI	7.270.739	697.211	1.688.083	211.937	3.359	6.046.571

II DETYRIMET DHE KAPITALI

Ne ketë pasqyre financiare janë paraqitur me vlerën kontabël neto te pagueshme pasivet afatshkurtra, pasivet afatgjata dhe kapitali.

I. Detyrimi Afatshkurtra, përbehen nga detyrimet qe do te shlyhen Brenda 12 muajve nga data e bilancit dhe me 31/12/2019 ato përbëhen nga:

3 . Te pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit , me vlere **1.219.434.829** leke , e cila përbëhet nga:

- Detyrime nga kreditore te ndryshëm për 207.670.576 leke, ku vlerën me te madhe e zënë interesat e papaguara te kredisë ne vlerën 162.261.251 leke,14.042.380 leke detyrimi te vendosur nga KLSH, 30.252.655 leke taksa Bashkije te pa arkëtuara dhe për tu paguar , dhe 1.114.290 leke detyrime ndaj kreditorëve te ndryshëm te cilët ne librat e kontabilitetit janë te pasqyruar ne mënyrë analitike .
- Te pagueshme ndaj furnitorëve për 1.011.764.253 leke
 - Fatura te pa likuiduara çelje* Leke 756.240.551
 - Fatura gjithsej për vitit 2019* leke 522.346.586
 - Fatura te likuiduara gjate vitit 2019* leke 266.822.884
 - Fatura te pa likuiduara Fatura ne fund viti* leke 1.044.764.253

Ne vlerën e detyrimit vlerën me te madhe e zënë faturat e palikujduara te OSHEE ne vlerën 866.923.898 leke dhe vlere 144.840.355 leke është e përbëre nga detyrimet e furnitorëve si me poshtë :

- Alpha solutions Grup ShPK për 23.111.575 leke
- Fat Grup ShPK për 29.594.604 leke

-Alen CO ShPK për 29.829.294 leke
 -Fjortes ShPK për 21.041.882 leke
 -Semani SRCURITY ShPK për 17.028.132 leke
 -Shoq . Atlantik 3 për 6.270.000 leke
 -Andi Hamo për 4.232.700 leke
 -Baseni Ujor për 3.128.359 leke
 dhe 10.603.809 furnitorë të tjerë për 26 subjekte .

- *Te pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurime shoqërore e shëndetësore për 14.715.445 leke, pagat e shoqërisë të palikujduara për muajin dhjetor 2019 e përbëre 10.515.145 leke e ndare paga punonjësve për 9.207.958 leke , page punonjësve Ujësjiellësi Novoselë dhe K.Mbikqyres Ujësjiellësi Novoselë ne vlerën 1.263.898 leke ,paga te papaguara K.A Vlorë 43289 leke .Sigurime shoqërore e shëndetësore për 4.200.300 leke .*
- *Te pagueshme për detyrime tatimore për 1.038.006 leke e cila është e përberë detyrim për TAP ne vlerën 518.290 leke,tatim ne burim ne vlerën 90.891 leke dhe detyrim e punonjësve me kohe te pjesshme për Ujësjiellësin Novoselë ne vlerën 428.825 leke .*

▪ **Detyrimet afatgjata** , rezultojnë me 31.12.2019 me gjendje **6.298.385.378** leke e cila është e përberë:

- ***Hua Afatgjate e akorduar nga Ministria e Financave ne vlerën 12.430.720,70 €** , dhe vlerësimi me 31.12.2019 është bere me kursin zyrtar te Bankës se Shqipërisë ne këtë date e cila është 121.77 leke ,dhe kapitalizmi i interesave te kredisë te vitit 2014 për 330.43,05 € vlera ne leke ne total është 1.556.085.091 leke.*
- ***Grande dhe te ardhura te shtyra** ,ne vlerën 4.742.300.287 leke e përbëre nga grandit i mare nga M.F për rrjetin ujësjiellës te bëra nga projekti Holandez **ne vlerën 2.152.840.874 leke** , , Grandit për ujësjiellësin e kanalizime Orikum ne vlerën 1.499.234.023 leke nga Banka Islamike, Grandit nga B E për kanalizime dhe ITUN Vlore ne vlerën 547.411.362 leke dhe Grand nga AKUK Tirane për makineri e pajisje për ITUN Vlore ne vlerën 181.195.325 leke dhe Grand nga BE për kanalizime dhe ITUN ne vlerën 361618.702 leke . Amortizimi i grandit për vitin 2019 pasqyrohet ne te ardhura dhe shpenzime ne vlerën 114.204.774 leke*

▪ **KAPITALI**

Kapitali i shoqërisë me 31/12/2019 rezulton ne vlerën **-60.997.337** leke dhe përbëhet nga:

1. **Kapitali i nënshkruar** , për 632.287.414 leke i cili i përgjigjet vendimit të gjykatës rrethit Tirane nr 26.332 date 10.07.2001 i ndryshuar është 457.808.215 leke dhe rritja e kapitalit prej 174.479.199 leke është rezultat i përthithjes së Ujësjiellësit Orikum dhe Novosele.
2. **Rezerve Statutore** ne vlerën 79.957.624 leke ,i cili është krijuar nga shpërndarje e fitimit ne vite .
3. **Rezerva ligjore** , për vlerën 15.000 leke ,i cili është krijuar nga shpërndarje e fitimit ne vite .
4. **Humbje e mbartur**,me vlerën – 571.121.432 leke e cila ka dhënë efekte negativ ne uljen e kapitalit te shoqërisë.
5. **Humbje e vitit financiar** ,për vlerën -202.135.943 leke ,e cila është e barabarte me rezultatin neto te pasqyrës financiare te ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2019.

III Pasqyra e te Ardhurave dhe shpenzimeve

Për periudhën 1 Janar 2019 deri ne 31 dhjetor 2019 shoqëria ka bere një sere shpenzimesh dha ka realizuar te ardhur , te cilat janë paraqitur ne mënyrë te rregullt ne llogarite e klasës 6 e 7, e te pasqyruara ne pasqyrën e te ardhurave dhe shpenzimeve, bazuar ne klasifikimin e shpenzimeve sipas natyrës.

Te ardhurat dhe shpenzimet e kryera i takojnë aktivitetit kryesor te shoqërisë siç janë , shpenzimet e blerjes se mallrave për mirëmbajtje rrjeti , pagat , sigurimet shoqërore, amortizimi dhe shpenzime te tjera ne shërbim te aktivitetit. Shpenzimet janë te kryera mbi bazën e dokumenteve baze kontabël , ligjore e te justifikuara.

Te ardhurat e siguruara nga aktiviteti i shoqërisë janë realizuar ne shifrën **691.771.728** leke dhe janë te përbëra nga:

1. Te ardhurat janë te siguruara aktiviteti kryesor,shërbimi i furnizimit me ujë te konsumatorëve , te cilat për vitin 2019 rezultojnë ne vlerën **275.720.578** leke .
2. Te ardhura nga sektori i kanalizimeve ne vlerën 44.335.325 leke.
3. Te ardhura nga aktivitet te tjera ne vlerën 25.960.865 leke e cila është e përbëre nga te ardhura për vendosje matësi për 1.001.876 leke , nga shitja e matesave te ujit 10.483.294 leke,nga lidhje e kontratave 8.288.415 leke , nga qiraja 672.000 leke ,nga 1% i mbledhjes se taksave te bashkise dhe te tjera ne vlerën 3.606.550 leke e përbëre nga sheshe ,çaktivizime , kamata e te tjera .
4. Te Ardhura te tjera për **345.754.961** leke e përberë nga :
 - a)Te ardhura nga subvencione për vitin 2019 për **120.679.542** leke ,nga Ministria e Linjës te vlerën 86.304.183 leke dhe nga Bashkia Vlore ne vlerën 21.801.192 leke dhe nga AKUM ne vlerën 12.574.164 leke .
 - b)Te ardhura nga amortizimi i garantit për vlerën **114.336.683** leke .
 - c) Te ardhura nga këmbime valutore si rezultat i rivlerësimit te gjendjes se kredisë me kursin e këmbimit me 31.12.2019 ne vlerën 110.738.574 leke .

Shpenzimet sipas natyrës për vitin 2019 janë për **893.907.671** leke e përberë si me poshtë :

1. Shpenzim për blerje mallra 55.967.219 leke
2. Te tjera nga veprimtari e shfrytëzimit 285.063.799 leke e përberë nga ;
 - a) Ruajtje objekti për 33.217.688 leke
 - b) Sigurime për 1.095.311 leke
 - c) shpenzime poste, telekom ,reklama ,internet për 1.164.868 leke
 - d) energji elektrike për 221.217.300 leke
 - e) shërbime bankare për 133.897 leke
 - f) Qira për 1.764.000 leke
 - g) Ekzekutimi i vendimeve përmbartimore për 6.091.164 leke
 - h) Paga Keshillit mbikëqyrës 570.000 leke
 - i) Dieta për trajnime për 1.061.211 leke
 - j) Shpenzime mirëmbajtje 7.195.055 leke
 - k) Printim i faturave te ujit 1.112.300 leke
 - l) Te tjera shpenzime 9.790.719 leke (llog 618) e cila është e përbëre : 3.128.359 leke Agjencia e Basenit Ujor, 1.911.267 leke tarifa ERRU dhe SHUKALB , 2.172.000 leke auditive ligjore , 736.000 leke mirëmbajtje sistem faturimi ,726.801 leke shërbim gjeologjik për studimin e burimeve ujore ,750.000 leke vlerësimi i seteve , dhe 351.792 leke analiza uji ,aktivitet 8 marsi,taksa Oshe, mirëmbajtje printer .
3. Shpenzime për personelin 213.787.636 leke e përbëre nga
 - a) pagat për 182.219.227 leke , te cilat shoqëria i ka llogaritur sipas pagave referuese, pagave reale dhe janë te likuiduara nëpërmjet bankës
 - b) sigurimet shoqërore për 30.350.736 leke . Ato janë llogaritur ne përputhje me legjislacionin qe vepron ne këtë fushe .
 - c) Shpenzime te tjera personeli, nentrajtime për vlerën 1.217673 leke.
4. Shpenzime amortizimi për 215.295.559 leke, e përbëre 211.936.520 leke amortizim vjetor dhe 3.359.039 leke zhvlerësim e Aktiveve te zëvendësuar . Amortizimi është llogaritur sipas normativave fiskale.

5. Shpenzime nga interesat për kredinë e projektit Holandez për 5.942.137 leke
6. Shpenzime gjore për 112.979 leke
7. Amortizim i shpenzimeve të shtyra në vlerën 117.738.342 leke, e cila është krijuar nga zbritja e klientëve familjar me faljen e detyrimeve të klientëve sipas VKM Nr 10418 datën 21.04.2015 "Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të Borxhit Tatimor dhe doganor", neni 30 dhe vendimit të Keshillit Mbikëqyrës Nr 8 datë 24.11.2015.

Rezultati financiar i shoqërisë është me humbje në vlerën 202.135.943 leke .

IV Pasqyra e Fluksit të Mjeteve monetare

Pasqyra e fluksit të parasë është hartuar në baze të metodës indirekte , sipas kësaj metode në pasqyrën e fluksit të parasë janë pasqyruar tepricat e posteve të bilancit , aktivitet dhe pasivitet . Pasqyra e fluksit të parasë paraqitet :

1. Mjete monetare neto nga veprimtari e shfrytëzimi 318.940.685 leke
2. Mjete monetare neto nga veprimtari nga veprimtaria investuese -679.210.952 leke
3. Mjete monetare neto nga veprimtari Financiare 365.076.328 leke
4. Rritja neto e mjeteve monetare për 4.806.061 leke

V Pasqyra e ndryshimeve në Kapital

Në këtë pasqyre janë pasqyruar ndryshimet në kapitalin e shoqërisë e cila ka pësuar **Ulje** e krahasuar me vitin 2018 prej 131 % . Ulja ka ardhur nga rezultati me humbje për vitin 2019. Kapitali i shoqërisë nga rezultatit me humbje për 4 vite rrjeshte ka dhënë efekte negativ në kapitalin e shoqërisë edhe pse kapitali i nënshkruar është në vlerën 632.287.414 leke . Për ndryshim të situatës së kapitalit propozoj që një pjese e gratit i përfituar nga ndërtimi i aktiveve të kalojë në shtesë të kapitalit të nënshkruar . Këto ndryshime duhet të bëhen me raportin të një ekspertize ligjore duke pasqyruar ndryshimet në pasqyrat financiare të vitit 2020 dhe në QKB.

P U N O I

Raimonda Alliaj